



SHQIPËRIA PËRFUNDON ME SUKSES MANDATIN SI KOORDINATORE E GRUPIT CEBS NË WIPO

Shqipëria ka përmbyllur me sukses mandatin njëvjeçar si Koordinatore e Grupit të Vendeve të Evropës Qendrore dhe Balltike (CEBS) pranë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), një rol që u drejtua nga znj. Xhesika Lulaj.

Gjatë këtij mandati, Shqipëria kontribuoi në koordinimin e qëndrimeve të përbashkëta të vendeve anëtare të grupit, forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe përfaqësimin e interesave të CEBS në proceset vendimmarrëse të WIPO-s.

Përmbyllja me sukses e këtij mandati vlerësohet si një arritje e rëndësishme për diplomacinë shumëpalëshe të Shqipërisë dhe si dëshmi e angazhimit aktiv të vendit në fushën e pronësisë intelektuale në nivel ndërkombëtar.

Drejtimi i mandatit nga Xhesika Lulaj u karakterizua nga koordinim efektiv, dialog konstruktiv dhe promovimi i bashkëpunimit mes vendeve anëtare të grupit, duke kontribuar në avancimin e prioriteteve të përbashkëta në kuadër të WIPO-s.

SHQIPËRIA I BASHKOHET TRAKTATIT TË SINGAPORIT PËR MARKAT TREGTARE



Singapore Notification No. 60

SINGAPORE TREATY ON THE LAW OF TRADEMARKS

Accession by the Republic of Albania

The Director General of the World Intellectual Property Organization (WIPO) presents his compliments to the Minister for Foreign Affairs and has the honor to notify the deposit by the Government of the Republic of Albania, on July 1, 2026, of its instrument of accession to the Singapore Treaty on the Law of Trademarks, adopted at Singapore on March 27, 2006.

The Treaty will enter into force, with respect to the Republic of Albania, on October 1, 2026.

The list of the States and the intergovernmental organizations party to the Singapore Treaty on the Law of Trademarks (status on July 1, 2026) is attached to this Notification.

July 1, 2026

Shqipëria ka hedhur një tjetër hap të rëndësishëm në forcimin e sistemit të mbrojtjes së pronësisë industriale. Më 1 korrik 2026, Republika e Shqipërisë depozitoi pranë Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) instrumentin e aderimit në Traktatin e Singaporit për të Drejtën e Markave, i miratuar më 27 mars 2006.

Traktati do të hyjë në fuqi për Shqipërinë më 1 tetor 2026, duke sjellë procedura më moderne dhe të harmonizuara për administrimin dhe mbrojtjen e markave tregtare, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Aderimi në këtë traktat përbën një nga angazhimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022–2025 dhe dëshmon përkushtimin e Shqipërisë për të forcuar kuadrin ligjor dhe institucional në fushën e pronësisë industriale, si edhe për të përmirësuar klimën e biznesit dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.




SHQIPËRIA I BASHKOHET TRAKTATIT TË NAIROBIT PËR SIMBOLIN OLIMPIK

Shqipëria ka depozituar pranë **Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO)** instrumentin e aderimit në **Traktatin e Nairobi për Mbrojtjen e Simbolit Olimpik**, duke u bërë zyrtarisht pjesë e këtij instrumenti ndërkombëtar.

Traktati garanton mbrojtjen ligjore të simbolit olimpik dhe ndalon përdorimin e tij për qëllime tregtare pa autorizimin e **Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC)**.

Aderimi në këtë traktat përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e sistemit të mbrojtjes së pronësisë industriale në Shqipëri dhe në harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare.

Ky zhvillim konfirmon angazhimin e vendit për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për mbrojtjen efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale.



PJESËMARRJA E SHQIPËRISË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË WIPO-S 2026

Nga data 7 deri më 15 korrik 2026, në selinë e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) në Gjenevë, u zhvillua Asambleja e Përgjithshme e WIPO-s, forumi më i rëndësishëm vjetor në fushën e pronësisë intelektuale, me pjesëmarrjen e delegacioneve nga 193 shtetet anëtare.

Republika e Shqipërisë u përfaqësua nga Ambasadorja Vasilika Hysi, Përfaqësuese e Përhershme e Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në Gjenevë, znj. Maria Solis Kapedani, Drejtor


i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, znj. Miranda Pistoli, First Secretary në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Gjenevë, znj. Sonila Meka, Drejtor i Komanduar i Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës në DPPI, si dhe znj. Xhesika Lulaj, Koordinatore e Grupit të Vendeve të Evropës Qendrore dhe Baltike (CEBS).

Gjatë punimeve të Asamblesë u trajtuan çështje me rëndësi strategjike për zhvillimin e sistemit ndërkombëtar të pronësisë intelektuale, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare dhe nismat që mbështesin inovacionin, krijimtarinë dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë forum të nivelit të lartë rikonfirmoi angazhimin e vendit për forcimin e sistemit të pronësisë intelektuale, thellimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe avancimin e objektivave të integritit evropian.



DPPI DHE ZYRA ITALIANE E PATENTAVE DHE MARKAVE (UIBM) NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI



Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Zyra Italiane e Patentave dhe Markave nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi (**MoU**) me synim forcimin e marrëdhënieve institucionale dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të pronësisë industriale.

Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, **znj. Maria Solis Kapedani**, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Italiane të Patentave dhe Markave, **z. Antonio Liroi**.

Bashkëpunimi parashikon shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira, organizimin e trajnimeve të përbashkëta, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e inovacionit, me fokus forcimin e mbrojtjes së patentave, markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë.

Kjo marrëveshje përfaqëson një hap të rëndësishëm në afrimin e sistemit shqiptar të pronësisë industriale me standardet evropiane, duke mbështetur zhvillimin e inovacionit dhe rritjen e konkurrueshmërisë.

HAPEN APLIKIMET PËR “YOUNG INVENTORS PRIZE 2027”



Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) njofton se Zyra Evropiane e Patentave (EPO) ka hapur thirrjen për aplikime për çmimin ndërkombëtar **“Young Inventors Prize 2027”**, i cili vlerëson shpikësit e rinj që zhvillojnë zgjidhje inovative për sfidat globale të qëndrueshmërisë.

Në këtë iniciativë mund të aplikojnë studentë, të sapodiplomuar, sipërmarrës dhe inovatorë të rinj nga e gjithë bota, ndërsa nuk kërkohet që shpikja të jetë e patentuar. **Afati i fundit për paraqitjen e nominimeve është 30 shtator 2026.** DPPI u bën thirrje të rinjve shqiptarë me ide inovative të aplikojnë dhe të përfaqësojnë Shqipërinë në këtë platformë prestigjioze ndërkombëtare, duke ftuar njëkohësisht universitetet dhe institucionet e kërkimit të promovojnë këtë mundësi.

Për më shumë informacion dhe aplikim:

<https://epo.newsweaver.co.uk/EUROPEAN-INVENTOR-AWARD/1xitqbmss3f76m7frywrx6/external?email=true&lang=en&a=6&p=66901237&t=30524067>

Kriteret e pranueshmërisë dhe procedura e aplikimit:

<https://epo.newsweaver.co.uk/EUROPEAN-INVENTOR-AWARD/16276hu1s5t76m7frywrx6/external?email=true&lang=en&a=6&p=66901237&t=30524067>

TAKIME ME BIZNESET LOKALE NË RADHIMË-ORIKUM PËR PROMOVIMIN E PRONËSISË INDUSTRIALE



Në vijim të angazhimit për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale, DPPI zhvilloi takime informuese me biznese lokale në zonën Radhimë–Orikum.

Këto takime u fokusuan në promovimin e vlerës që sjell regjistrimi i markave tregtare, dizajneve industriale dhe objekteve të tjera të pronësisë industriale, si instrumente të rëndësishme për mbrojtjen e identitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit.

Gjatë bisedave me sipërmarrësit, u diskutua mbi përfitimet që u ofron regjistrimi i të drejtave të pronësisë industriale, duke theksuar rolin e tyre në rritjen e konkurrueshmërisë, forcimin e besueshmërisë në treg dhe mbrojtjen e mbi përfitimet që inovacionit.

Përfaqësuesit e DPPI-së ofruan informacion mbi procedurat e regjistrimit dhe rëndësinë e krijimit të një kulture të qëndrueshme të respektimit dhe mbrojtjes së pronësisë industriale.

Takimet me biznese lokale do të vijojnë edhe në zona të tjera të vendit, si pjesë e misionit të DPPI për të afruar shërbimet dhe informacionin pranë sipërmarrësve, duke nxitur zhvillimin e një ekonomie më inovative dhe më konkurruese.

Regjistrimi i markës tregtare mbetet një investim strategjik që mbron identitetin e biznesit ofruan gjithashtu informacion dhe krijon vlerë afatgjatë për çdo sipërmarrje.

TAKIME NDËRGJEGJËSUESE ME BIZNESET NË QYTETIN E VLORËS PËR RËNDËSINË E PRONËSISË INDUSTRIALE



Në kuadër të misionit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) zhvilloi një sërë takimesh ndërgjegjësuese me biznese në qytetin e Vlorës. Këto aktivitete synuan të rrisin ndërgjegjësimin e sipërmarrësve mbi rëndësinë e mbrojtjes së markave tregtare, dizajneve industriale dhe objekteve të tjera të pronësisë industriale si një aset i çmuar për zhvillimin e biznesit.

Gjatë takimeve, përfaqësuesit e DPPI informuan bizneset mbi përfitimet që sjell regjistrimi i markës tregtare, duke theksuar rolin e saj në mbrojtjen e identitetit të biznesit, rritjen e besueshmërisë në treg dhe forcimin e konkurrueshmërisë. Gjithashtu, u prezantuan procedurat e regjistrimit dhe shërbimet që ofron institucioni për mbështetjen e sipërmarrësve në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Përmes dialogut të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e bizneseve, u diskutuan sfidat dhe nevojat konkrete të sipërmarrjes vendase, duke inkurajuar krijimin e një kulture të qëndrueshme të respektimit dhe mbrojtjes së pronësisë industriale.

DPPI do të vijojë organizimin e takimeve të tilla informuese në qytete të ndryshme të vendit, me synimin për të ofruar informacionin dhe shërbimet pranë komunitetit të biznesit dhe për të nxitur inovacionin, zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen efektive të aseteve të pronësisë industriale.

KORÇË, FUSHATË NDËRGJEGJËSUESE PËR MBROJTJEN E PRONËSISË INDUSTRIALE

Në qytetin e Korçës është zhvilluar një fushatë ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e pronësisë industriale dhe mbrojtjen e të drejtave të krijuesve dhe bizneseve.

Aktiviteti kishte si qëllim informimin e komunitetit mbi vlerën e patentave, markave tregtare, modeleve industriale dhe risive të krijuara nga individë apo sipërmarrje.

Gjatë takimeve informuese u theksua se respektimi i pronësisë industriale ndihmon në zhvillimin e biznesit, nxit inovacionin dhe mbron punën krijuese nga përdorimi i paautorizuar. Përfaqësues dhe specialistë të fushës u kanë shpjeguar sipërmarrësve procedurat dhe përfitimet që sjell regjistrimi dhe mbrojtja ligjore e produkteve dhe krijimet e tyre unike.

Fushata synoi të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe sipërmarrësve të Korçës për rëndësinë e pronësisë industriale si një faktor të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë e bizneseve. Aktivitete të tilla informuese do të vijojnë edhe në të ardhmen, me qëllim respektimin dhe ndërgjegjësimin e palëve mbi të drejtat e pronësisë intelektuale.

